




FORCIMI I KAPACITETEVE KOMBETARE PER RUAJTJEN E NATYRES – PERGATITJA PER RRJETIN NATYRA 2000

RUAJTJA E BIODIVERSITETIT NE SHQIPERI

Termi “biodiversitet” është një formë e shkurtuar e “Diversitetit Biologjik” dhe ju referohet të gjitha llojeve të ndryshme dhe formave të jetës në një vend të caktuar, qoftë ai i vogël si një trung peme i rrëzuar apo i madh sa gjithë planeti Tokë. Biodiversiteti u siguron të gjitha qënieve njerëzore të mira dhe shërbime të shumta, si ushqime, lëndë djegëse, ilaçe, lëndë të para, uji dhe ajrin e pastër. Ai na mundëson të jetojmë shëndetshëm dhe është pjesë jetike e proceseve ekologjike që e bëjnë të mundur jetën në Tokë. Biodiversiteti u krijon mundësinë ekosistemeve që t’iu përshtaten ndryshimeve natyrore si moti ekstrem, zjarret dhe përmbytjet. Bukuria e tij frymëzon dhe pasuron jetët tona, ndaj ne duhet ta mbrojmë atë për të garantuar mbijetesën e tij dhe tonën.



Megjithëse një vend i vogël, Shqipëria është shumë e pasur në diversitetin biologjik. Diversiteti i jashtëzakonshëm i ekosistemeve dhe habitateve përfshin 3’200 bimë enëzore, 2’350 bimë jo-enëzore dhe 15’600 lloje rruazorësh e jo-rruazorësh, shumica e të cilave janë të kërcënuara në nivel global apo evropian. Në mirënjohje të kontributit madhor të Shqipërisë ndaj biodiversitetit global dhe evropian, Bashkimi Evropian financon projektin “Forcimi i Kapaciteteve Kombëtare për Ruajtjen e Natyrës – Përgatitja për Rrjetin Natura 2000”.

Zonat e Mbrojtura janë elementë thelbësorë për mbrojtjen e natyrës dhe shpesh janë mënyrat më të sigurta për të ruajtur diversitetin e ekosistemeve. Shqipëria kohët e fundit ka bërë progres të konsiderueshëm në zgjerimin e rrjetit të zonave të mbrojtura nga 5.2% të territorit të vendit në 2005 në 16% të territorit në 2014. Pavarësisht këtij

progresi të ndjeshëm, investimet në zonat e mbrojtura, në veçanti në infrastrukturë, pajisje dhe kapacitete teknike të stafit, kanë qenë të pamjaftueshme. Aktivitetet e projektit fokusohen në implementimin e planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura, të përzgjedhura pas një vlerësimi të gjendjes së sistemit kombëtar të zonave të mbrojtura dhe një sërë kriteresh të tjera. Mbështetja për zbatimin e planeve të menaxhimit në këto zona fokusohet në zhvillimin dhe zbatimin e një programi gjithëpërfshirës për ngritjen e kapaciteteve të personelit të zonave të mbrojtura dhe zbatimin e aktiviteteve specifike, planet që lidhen me infrastrukturën, pajisjet, konservimin e llojeve dhe habitateve prioritare dhe monitorimin e biodiversitetit. Menaxherët e zonave të mbrojtura gjithashtu do të trajnohen dhe asistohen në zhvillimin e projekt propozimeve për të marrë financime në të ardhmen nga programet e BE-së.

OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Të ndalojë humbjen e biodiversitetit nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të zonave të mbrojtura në Shqipëri nëpërmjet:

- Zbatimit të të paktën 5 planeve të menaxhimit ekzistuese në zonat e mbrojtura të përzgjedhura;
- Përgatitjes së një liste paraprake të zonave NATURA 2000 për vendin me qëllim paraqitjen e tyre te Komisioni Evropian nga autoritetet shqiptare në të ardhmen.

RUAJTJA E BIODIVERSITETIT NE SHQIPERI



Mbrojtja e biodiversitetit në Shqipëri do të forcohet më tej nga përgatitja e një liste paraprake të zonave Natura 2000 në vend, me qëllim dorëzimin e tyre në të ardhmen tek Komisioni Evropian. Këto zona do të jenë pjesë e Rrjetit NATURA 2000 i cili përfshin zona të rëndësishme për shumimin dhe strehimin e specieve të rralla dhe në rrezik zhdukje, si dhe tipe të rralla habitatesh natyrore të cilat duhen ruajtur. Qëllimi i këtij rrjeti është të sigurojë mbijetesën afatgjatë për llojet dhe habitatet më të vlefshme dhe më të kërcënuara të Evropës,

të listuara si në Direktivën për Shpendët dhe Direktivën për Habitatet. Projekti gjithashtu mbështet aktivitetet për informimin, komunikimin dhe edukimin e një sërë grupesh interesi, si vizitorët e zonave të mbrojtura, komunitetet lokale, menaxherët e burimeve natyrore dhe aktorë të tjerë, për rëndësinë e ruajtjes së natyrës në Shqipëri dhe rolin e zonave të mbrojtura. Këto aktivitete synojnë të ndërgjegjësojnë dhe të nxisin publikun për ti mbështetur dhe për t'u përfshirë në aktivitetet e projektit.

ZONAT E PERZGJEDHURA

Përmirësimi i ruajtjes së biodiversitetit në zonat e mbrojtura është fokusi kryesor i këtij projekti. Projekti fokusohet në mbështetjen dhe zbatimin e planeve të menaxhimit ekzistuese në disa zona të mbrojtura që janë përzgjedhur si zona pilot.

- Në zbatim të një sërë parimesh dhe kriteresh të dakortësuara, 5 zona të mbrojtura janë përzgjedhur si zona kryesore pilot: (1) RNM Liqeni i Shkodrës; (2) RNM Korab-Koritnik; (3) PK Divjaka-Karavasta; (4) PK Mali i Tomorrit; dhe (5) PK Bredhi i Hotovës-Dangëlli.
- Përveç 5 zonave kryesore pilot, aktivitete më të kufizuara do të zbatohen gjithashtu në zonat pilot dytësore: (1) PM Lumi Buna-Velipojë; (2) PK Mali i Dajtit; (3) PK Shebenik-Jabllanica; (4) PM Vjosa – Narta; dhe (5) PK Llogara.

PK – Park Kombëtar, RNM – Rezerve Natyrore e Menaxhuar, PM – Peizazh i Mbrojtur

Financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të Instrumentit për Asistencë Para Anëtarësimin (IPA 2013).

Partnerët e projektit:

Drejtorja e Përgjithshme për Bashkëpunimin për Zhvillim të Ministrisë Italiane të Punëve të Jashtme (MAECI/DGDC); Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës, (IUCN) dhe Shoqëria Botanike Italiane (SBI)

Përfituesit:

Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Agjencitë Rajonale për Zonat e Mbrojtura

Kohëzgjatja:

40 muaj



Kontakt:

IPA 2013 - Natura 2000
Torre Drin, Kati i 5 –të,
Tirana, Albania
Tel: +35542240880/1/2/3
Email: info@natura.al

www.natura.al